



Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality



Drejtoria Për Kulturë Rini e Sport
KOMUNA E DRAGASHIT
REPUBLIKA E KOSOVËS
Opština Dragaš

№ Nr. Br. 644/1-1880

23.01. 20 20

Dragash - Dragaš

Dragash, 24.01.2020

Drejtoria Për Kulturë Rini e Sport u bën:

THIRRJE PUBLIKE

1. Të gjitha Organizatave Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i së cilave është i fokusuar në **fushën e kulturës** dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Dragashit të aplikojnë për mbështetje financiare:

- ✓ **Organizimi i Festës së Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës- 17 Shkurtit dhe prezantimi i traditës dhe kulturës së Komunës së Dragashit në festivale kombëtare e ndërkombëtare**

Vlerësimi profesional do të bëhet nga komisioni profesional prej 5 anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullores për kushtet, Kriteret për Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

2.Vlerësimi do të bëhet sipas:

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit;
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes;
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit për afirmimin ndërkombëtarë të Komunës së Dragashit
5. Cilësisë artistike të projektit;
6. Originalitetit të projektit.

3.Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:

- ✓ Formulari i aplikacionit për projekt/ program
- ✓ Formulari i propozim-buxhetit
- ✓ Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë
- ✓ Dokumenti identifikues (fotokopje e shtypur)
- ✓ Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje e shtypur)
- ✓ Konfirmim nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit
- ✓ Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore ndaj ATK-së, jo më të vjetër se 6 muaj
- ✓ Dëshmi të implementimit projekteve/ programeve të ngjashme

4. Formulari për aplikim mund të merret në web-faqen e Komunës dhe mund të dorëzohet nga 24.01.2020 deri më 13.02.2020 (15 ditë pune). Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e Prokurorit (Arkivi) Nr. 1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit
Për: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

5. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare

Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej 7000- 9000 €

Aplikimet

1. OJQ-të në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Dragashit.
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës.
4. OJQ-të duhet poashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Dragashit- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Dragashit.
6. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

7. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Vërejtje:

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave. Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen dhe në mënyrë elektronike, duke dërguar email në adresën dkrs.dragash@gmail.com

Drejtori i Drektoriatit për Kulturë Rini dhe Sport

Lirim Hajredini